


Dr. Zakir Naik

KONCEPTI

PËR ZOTIN

në fetë e mëdha



Dr. Zakir Naik

KONCEPTI I ZOTIT NË FETË E MËDHA

Prishtine, 2009

Titulli në origjinal:

Concept of God in Major religions

Autor:

Dr. Zakir Naik

Perkthyen:

Grup përkthyesish

Redaktor fetar:

Agron Terziqi

Redaktor gjuhësor:

Arian Koçi

Përgatitja kompjuterike:

Bashkim Avdiu

Ballina:

Dorlir Kraja

Përmbajtja

HYRJE.....	7
KATEGORIZIMI I FEVE TË MËDHA BOTËRORE	10
Fetë semitike	10
Fetë josemitike.....	11
Fetë' ariane	11
Fetë joariane.....	12
PËRKUFIZIMI ME AUTENTIK PËR ZOTIN	13
KONCEPTI I ZOTIT NË HINDUIZËM	14
Koncepti i rëndomtë i Zotit në Hinduizëm	14
Bhagavad Gita	17
Upanishadet	17
Vedat.....	20
2. Atharvaveda.....	21
3. Veda Rig.....	22

Pika e përbashkët e vedave hinduse.....	25
KONCEPTI I ZOTIT NË SIKHIZEM.....	27
Përkufizimi i sikhut dhe i Sikhizmit	27
Pese shkronjat ‘K’	28
Mul Mantra - Besimi fundamental i Sikhizmit	29
Guru Nanak i ndikuar nga Kabiri.....	30
KONCEPTI I ZOTIT NË ZOTOASTRIANIZËM.....	32
Cilësitë e Zotit sipas Dasastir	32
Cilësitë e Zotit bazuar në Avesta.....	33
KONCEPTI I ZOTIT NË JUDAIZËM.....	35
KONCEPTI I ZOTIT NË KRISHTERIZËM..	38
Misioni i Jezu Krishtit! Ai erdhi për të plotësuar shpalljen	40
Zoti e dërgoi Jezusin.....	41
Jezusi i Nazaretit - njeri i aprovuar nga Zoti	43
Urdhri i parë: Zoti është Një	44

KONCEPTI I ZOTIT NË ISLAM	46
Përkufizimi me konciz për Zotin.....	47
'Surja Ihlas' - kriter i teologjisë	48
Ç 'thotë Islami për 'njeriun-zot'?	49
Si e quajmë Zotin?.....	52
Zoti nuk personifikohet në qenie njerëzore	53
Adhurimi kushtuar njerëzve është i padobishëm.	55
Zoti nuk kryen vepra johyjnore.....	56
Zoti nuk harron e as nuk gabon	57
Zoti kryen vepra hyjnore	57
Krijuesi përgatiti (udhëzuesin) e përdorimit.....	58
Allahu zgjedh të Dërguarit.....	59
EMRAT DHE CILËSITË E ZOTIT.....	61
NJËSHMËRIA E ZOTIT.....	66
Te gjitha fetë në fund të fundit besojnë në monoteizëm.....	69

Njerëzit i kanë ndryshuar shkrimet e shenjta për përfitime personale.....	69
TEUHIDI.....	71
Përkufizimi dhe kategoritë.....	71
I. Teuhidi rububije (njësimi i Allahut si Zot, Krijues e Sundues i të gjitha krijesave).....	71
II. Teuhidi ‘esma ue sifat’ (njësimi i Allahut në të gjithë emrat dhe Cilësitë e Tij).....	72
IIITEuhidi uluhije (njësimi i Allahut në adhurim)	75
SHIRKU.....	78
a. Përkufizimi	78
b. Shirku është mëkati më i madh, të cilin Allahu nuk e fal	78
c. Shirku shpie në zjarr të xhehenemit.....	79
d. Adhurimi duhet të jete vetëm për Allahun	80
PËRFUNDIM.....	81

HYRJE

Njëri prej tipareve dalluese të civilizimit tonë është prania e një numri të madh feshë dhe bindjesh etike. Njeriu gjithmonë është përpjekur ta kuptojë qëllimin e krijimit të tij dhe vendin përkatës në skemën e gjërave.

Historiani Arnold Toynbe ka studiuar historinë e njeriut përgjatë kohërave dhe i ka radhitur zbulimet e tij në një vepër monumentale prej dhjetë volumesh. Ai arrin në përfundimin se në historinë e njeriut feja zë vend qendror. Në një artikull të botuar në 'The Observer,' me 24 tetor 1954, ai ndër të tjera shkruan:

"Kam arritur në përfundimin se religjioni mban çelësin e misterit të ekzistencës."

Religjioni, sipas fjalorit të Oxford-it, do të thotë «besim në një fuqi kontrolluese mbinjerëzore, në veçanti në Zot (apo zota), i vlerësuar si i denjë për bindje dhe adhurim.

Një veçori e përbashkët e të gjitha feve, të cilat karakterizohen nga një numër i madh besimtarësh është besimi në një Zot universal, respektivisht në një Autoritet Suprem e Hyjnor, i cili është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijsëm. Pasuesit e të gjitha feve të tilla besojnë se Zoti, të cilin ata e adhurojnë, është po Ai Zot edhe për të tjerët.

Marksizmi, Frojdianizmi dhe bindjet e tjera 'joreligjioze', në anën tjetër, u munduan t'i sulmojnë rrënjët e organizimit fetar. Por, në fund, ato vetë u shndërruan në sisteme besimi. Fjala vjen, kur komunizmi ishte formë qeverisjeje në shumicën e shteteve të botës, ai predikohej me shumë përkushtim dhe zell, si të ishte predikim apo propagandim fetar.

Kështu që themi se feja është pjesë përbërëse e ekzistencës njerëzore.

Ne Kuranin e Madhëruar thuhet:

"Thuaju (o i Dërguar): "O ithtarë të librit. Ejani (t'i bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejte) mes nesh dhe mes jush: Të mos

adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjnë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njeri-tjetrin zot pos Allahut. E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)."¹

Studimi i feve të ndryshme ishte një eksperiencë shumë e frytshme për mua. Kjo më shtoi bindjen se Zoti e ka krijuar secilin shpirt me dituri për ekzistimin e Tij. Ndërtimi psikologjik i njeriut është i tillë që e pranon ekzistimin e Krijuesit, përderisa nuk është i kushtëzuar të besojë të kundërtën. Me fjalë të tjera, besimi në Zot nuk kërkon kushte, kurse mohimi po!

¹ Kuran, 3: 64.

KATEGORIZIMI I FEVE TË MËDHA BOTËRORE

Në kuptimin e gjerë, fetë botërore mund të kategorizohen në fe semitike dhe josemitike. Ndërkaq, fetë josemitike mund të ndahen më tej në fe ariane dhe joariane.

Fetë semitike

Fetë semitike kane zënë fill në mesin e semiteve, prandaj quhen kështu. Sipas Biblës, Profeti Nuh (Noa) kishte një djalë të quajtur Sam, pasardhësit e të cilit sot njihen si semitë. Ky grup feshë ka nisur në mesin e çifutëve, arabëve, asirianëve, fenikasve; etj. Fetë kryesore semitike janë: Judaizmi, Krishterimi dhe Islami. Keto janë fe profetike dhe si rrjedhojë besojnë në Udhëzimin Hyjnor, të shpallur përmes Profetëve të Zotit.

Fetë josemitike

Fetë josemitike mund të ndahen me tej në fe ariane dhe joariane.

Fetë' ariane

Ky grup feshë ka zënë fill në mesin e arianëve, një popullsi e fuqishme, folëse e gjuhës indoevropiane, që ishte shpërndarë në Iran dhe Indi Veriore në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë, p.l.k. (vitet 2000-1500):

Fetë ariane me tej mund të ndahen në fe vedike² dhe jovedike.

Fetë vedike rëndom përfaqësohen nga Hinduizmi ose Brahmanizmi. Kurse fetë jovedike janë: Sikhizmi, Budizmi, Jainizmi etj. Pothuajse të gjitha fetë ariane janë fe joprofetike.

² Vedat janë një numër i madh shkrimesh të lashta indiane, të cilat konsiderohen si të shenjta nga hindusët.

Zoroastrianizmi, në anën tjetër, është një fe ariane, jovedike e cila nuk lidhet me Hinduizmin, por që pretendon të jetë fe profetike.

Fetë joariane

Fetë joariane kanë origjina të ndryshme. Konfucianizmi dhe Taoizmi janë me origjinë kineze, ndërsa Shintoizmi ka origjinë japoneze. Shumë prej feve joariane nuk e kanë konceptin e Zotit, prandaj do të ishte më mirë që t'u referoheshim si bindje etike sesa si fe.

PËRKUFIZIMI ME AUTENTIK PËR ZOTIN

Koncepti i përqafuar nga një fe për Zotin nuk mund re gjykohet thjesht duke vëzhguar praktikën e ndjekësve të saj. Është thuajse e rëndomtë që ndjekësit e shumë prej feve të jenë injorantë për konceptin e Zotit në librat e tyre të shenjtë, prandaj do të ishte e udhës që konceptin e Zotit në një feta analizojmë duke iu referuar librave të shenjtë përkatës.

Le ta kuptojmë konceptin e Zotit në fetë e mëdha botërore përmes analizimit të asaj që thuhet në librat e shenjtë të këtyre besimeve.

KONCEPTI I ZOTIT NË HINDUIZËM

Feja që ka më shumë ithtarë në mesin e feve ariane është Hinduizmi. 'Hindu' është fjalë me origjinë perse, e përdorur për të emërtuar banorët e luginës Indus. Sidoqoftë, në zhargonin e rëndomtë është një term gjithëpërfshirës që ngërthen shumë lloje të besimeve fetare, shumica e të cilave janë të bazuara në Veda, Upanishade³ dhe në Bhagavad Gita.⁴

Koncepti i rëndomtë i Zotit në Hinduizëm

Hinduizmi rëndom perceptohet si fe politeiste. Në fakt, shumica e hindusëve e vërtetojnë këtë bindje duke e shfaqur besimin e tyre në shumë zota. Disa prej tyre besojnë në

³ Shkrime të shenjta hinduse, të cilat perbejne rrethin e mësimeve për çlirimin shpirtëror, me qëllim të njohjes së Zotit.

⁴ Poezi epike indiane, e cila konsiderohet e shenjtë nga hindusët.

sistemin e tre zotave, ndërsa disa të tjerë besojnë në ekzistimin e 330 milionë zotave. Sidoqoftë, të diturit e tyre, ata që i njohin mirë shkrimet e shenja hinduse, insistojnë se duhet të besohet dhe të adhurohet vetëm një Zot.

Dallimi kryesor midis besimit hindus dhe atij islam përbëhet nga e ashtuquajtura filozofi e panteizmit. Panteizmi⁵, çdo gjë frymore dhe jofrymore e konsideron si hyjnore dhe të shenjtë. Kështu, hindusët i shohin drunjtë, Detin, Hënën, kafshët, madje edhe njerëzit, si shfaqje (manifestim) të Zotit. Për një hindus të rëndomtë gjithçka është Zot.

Sipas panteizmit, Zoti nuk ekziston i ndarë nga universi, por i mishëruar me krijesat. Pra, çdo gjë është Zot dhe Zoti është çdo gjë.

Islami, në anën tjetër, e nxit njeriun që ta konsiderojë veten dhe ata që e rrethojnë si shenja të krijimit hyjnor e jo si Hyjnia vetë.

⁵ Panteizmi është pikëpamje filozofike sipas se cilës do gjë në univers konsiderohet Zot.

Muslimanët besojnë se çdo gjë është e Zotit, drunjtë, Dielli, Hëna dhe çdo gjë tjetër në këtë univers i përket Atij.

Pra, dallimi kryesor në mes besimit hindu dhe atij islam është dallimi në nyjën e përparme 'e'. Hindusët thonë se gjithçka është Zot, kurse muslimanët thonë se gjithçka është e Zotit, duke e shtuar nyjën e përparme 'e'.

Ne Kuran thuhet:

“Ejani (të bashkohemi) të një fjalë që është e njëjtë mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë pos Allahut.. . ” Pra, gjëja e parë e përbashkët është adhurimi vetëm i Allahut.

Le të përpiqemi të gjejmë ngjashmëri në mes Islamit dhe besimit hindus duke analizuar shkrimet e shenjta përkatëse.

Bhagavad Gita

Ne mesin e të gjitha shkrimeve të shenjta hinduse, Bhagavad Gita është me e popullarizuara. Analizoni versetin e mëposhtëm nga Gita:

"Ata, inteligjenca e të cilëve është grabitur nga dëshirat materiale, të dorëzuar të gjysmë-perënditë, i ndjekin pjesërisht rregullat dhe ligjshmëritë e adhurimit, duke u bazuar në natyrën e tyre."⁶

Gita u referohet njerëzve të cilët janë materialistë dhe si të tillë i adhurojnë gjysmëperënditë, përveç; Zotit të vërtetë.

Upanishadet

Upanishadet po ashtu konsiderohen si shkrime të shenjta nga hindusët. Analizoni versetin vijues nga Upanishadet:

I) "Ekam evaditiyam. "

⁶ Bhagavad Gita, kapitulli 7, verseti 20.

“Ai është një, i vetëm dhe i pashoq.”⁷

II) Shqyrtoni edhe këtë verset të marrë nga Upanishadet:

“Na casya kasuj janita na cadhipah. ”

“Ai nuk ka prindër e as Zot.”⁸

III) Analizoni edhe versetet e mëposhtme, të marra nga Upanishadet:

"Na tasya pratima asti."

"Askush nuk i përngjet Atij.”⁹

"Nainam urdhvam na tiryana cam na madhye na pari-j-agrabhat na tasy pratime asti yasya nama mahad yasa h.”¹⁰

"Atij nuk i përngjet askush! Emri i të cilit është lavdimadh." Krahasoni versetet e

⁷ Chandogya Upanishad 6:2 :1.

⁸ Svestasavatara Upanishad 6,9 [pjesa II faqë 263].

⁹ Svestasavatara Upanishad 4,19.

¹⁰ Upanishadi kryesor nga S. Radhakrishnan, faqet 736 dhe 737. Librat e shenjtë të Lindjes, volumni 15, Upanishadi. pjesa II, faqë 253.

lartpërmendura me ajetet nga Kurani i Madhëruar:

"Asgjë nuk i përngjet Atij."¹¹

IV) Verseti vijues nga Upanishadet aludon për pamundësinë e njeriut për ta imagjinuar formën e Zotit:

"Na sarndrse tisthati rupam asya na caksusa pasyati kas canaiam. Hrda. hrdistham manasa ya enarn, evam vid- ur a1nrtas të bhavanti."

"Forma e tij nuk mund të shihet! Askush nuk e sheh Atë me sy. "¹²

Kurani i Madhëruar i referohet këtij aspekti ne ajetin vijues:

"Shikimet nuk mund ta përfshijnë Atë e Ai i përfshin shikimet. Ai është shumë i kujdesshëm, hollësisht i njohur."¹³

¹¹ Kuran, 42:11.

¹² Svestasvatara Upanishad 4:20.

¹³ Kuran, 6:103.

Vedat

Vedat konsiderohen si shkrimet me të shenjta në mesin e të gjitha shkrimeve hinduse. Ekzistojnë 4 veda kryesore: Veda Rig, Veda Yajur, Veda Sam dhe Atharv-aveda.

1. Veda Yajur

I) Analizoni versetin e mëposhtëm nga Veda Yajur:

"Na tasya primat asti."

"Ai nuk ka imazh."¹⁴

Me tej thuhet: "Përderisa nuk është i lindur, Ai e meriton adhurimin tonë. "

"Ai nuk ka imazh, lavdi i të cilit është i madh. I cili i mban në Vetën e Tij të gjitha objektet e shndritshme (p.sh. Diellin). Të mos më dëmtojë, kjo është lutja ime! Përderisa nuk është i lindur, Ai e meriton adhurimin tonë."¹⁵

¹⁴ Yajurved, 32:3.

¹⁵ Veda Yajur nga Devi Chand, M.A. faqe 377.

II) "Ai nuk ka trup dhe është i pastër."
Përmendet në veden Yajur.¹⁶

III) Po ashtu thuhet:

"Andhatama pravishanti ye asambhuti
mupaste."

"Ata hyjnë në errësirë! Ata të cilët adhurojnë
gjërat natyrore. Ata zhyten në errësirë! Ata të
cilët adhurojnë gjërat e krijuara (sambhuti). "¹⁷

Gjithashtu përmendet edhe një lutje:

"Na drejto në rrugën e drejtë dhe largoji prej
nesh mëkatet, të cilat na shpien në devijim dhe
çoroditje. "¹⁸

2. Atharvaveda

Analizoni versetet vijuese nga Atharvaveda:

"Dev mahsa osi."

¹⁶ Yajurved 40:8.

¹⁷ Yajurved 40:9.

¹⁸ Yajurved 40:16.

"Me të vërtetë Zoti është i madh."¹⁹

"Me të vërtetë, Perëndi, ti je i madh; me të vërtetë ti je i madh. Përderisa je i madh, madhështia Jote duhet admiruar. Po, me të vërtetë, i madhëruar je, o Zot!"²⁰

Një mesazh i ngjashëm është dhënë në Kuran, në suren Rad:

"Ai është i Madhëruari e i Lartësuari."²¹

3. Veda Rig

I) Me e vjetra në mesin e të gjitha vedave është Veda Rig. Ajo konsiderohet njëkohësisht edhe më e shenjtë. Në Vedën Rig përmendet se "Sagët" (murgjit e ditur) e thërrasin Zotin me shumë emra.²²

¹⁹ Atharvaveda 20, 58:3.

²⁰ Atharvaveda Samhici, vol. 2, William Dmighit Whitney, f. 910.

²¹ Kuran, 13:9.

²² Rigveda 1:164:46.

II) Veda Rig jep 33 emra të ndryshëm të Zotit të Plotfuqishëm, shumica e të cilëve përmenden ne Librin e dytë të Vedes Rig, konkretisht në himnin e parë. Njeri ndër emrat nl të bukur, në mesin e shumë emrave të përmendur në Vedën Rig, është 'Brahma'.²³ Brahma do të thotë Krijues. Në gjuhën arabe ky emër korrespondon me emrin 'Halik.' Muslimanët nuk mund të kenë ndonjë kundërshtim nëse Zoti i Plotfuqishëm përmendet si 'Halik: "Krijues)" ose 'Brahma Sidoqoftë, muslimanët në asnjë mënyrë nuk pajtohen me pikëpamjen hinduse se Brahma është Zoti i Plotfuqishëm me katër koka.

Madje përshkrimi i Zotit të Plotfuqishëm me terma antropomorfikë bie ndesh edhe me versetin e mëposhtëm të Vedës Yajur:

"Na tasa Pratima asti."

*"Ai nuk ka imazh."*²⁴

²³ Veda Rig, Subh 11, verseti 3.

²⁴ Yajur Ved 32:3.

Një tjetër emër i bukur, i përmendur në Veden Rig²⁵, është 'Vinshu' që do të thotë 'Zot' Në gjuhën arabe ky emër korrespondon me emrin 'Rrab' Përsëri themi se muslimanët nuk mund të kundërshtojnë nëse njerëzit e përmendin Zotin si 'Rrab' ose si 'Vinshu.' Mirëpo, në mesin e hindusve, Vinshu përfytyrohet si Zot me katër duar, duke mbajtur një disk me njërën nga duart e tij të djathta dhe një guaskë (të kërmillit të detit) në njërën nga të majtat, zakonisht i hipur mbi një zog ose i shtrirë në një shtrat prej gjarpri. Kuptohet që kjo për muslimanët është e papranueshme. Ngjashëm, kjo bie ndesh edhe me Vedën Yajur (kapitulli 40, verseti 19).

Analizoni versetin e mëposhtëm nga Veda Rig:

"Ma chindanyadvi shansata."

"O shokë, mos adhuronit dikë tjetër përveç Tij,

²⁵ Libri II, himni 1, vereset i 3.

Hyjnorit!²⁶

IV) "Jogët (praktikuesit e jogës)²⁷ e ditur i përqendrojnë mendjet e tyre dhe rrjedhimisht edhe mendjet e tyre te Realiteti Suprem, i cili gjendet kudo, i madhëruar dhe i Gjithëdijshtëm. Ai, i vetëm, duke i njohur funksionet e organeve shqisore, ua përcaktoi atyre detyrat përkatëse. Me të vërtetë i madh është lavdi për Krijuesin Hyjnor.'²⁸

Pika e përbashkët e vedave hinduse

Pika e përbashkët e vedave hinduse eshre:

"Ekam Brahm, dvitiya naste neh na naste kinchan."

²⁶ Rigveda , Libri 8:1:1.

²⁷ Joga (Yoga) është disiplinë tradicionale, fizike dhe mentale, e cila e ka origjinën nga India. Përbehet nga lëvizje të caktuara dhe aplikohet për qëllime të ndryshme, prej përmirësimit të shëndetit e deri te synimi për çlirim shpirtëror.

²⁸ Rigveda 5:81.

'Ekziston vetëm një Zot! Jo dy."

Duke e përfunduar këtë pjesë, themi se vetëm një studim i paanshëm i shkrimeve të shenjta hinduse mund ta ndihmojë njeriun që ta kuptojë konceptin e Zotit në Hinduizëm.

KONCEPTI I ZOTIT NË SIKHIZEM

Sikhizmi është një fe josemitike, ariane, jovedlike. Nuk është një fe e madhe botërore, por një drejtim i Hinduizmit, themelues i të cilit është Guru²⁹ Nanak. Sikhizmi ka zënë fill në fund të shek. XV në zonën e Pakistanit dhe të Indisë veriperëndimore, konkretisht në një pjesë të quajtur Punxhab (që d.m.th. vendi i pesë lumenjve). Guru Nanak ka lindur në një familje që i përkiste kastës luftëtare, me përkatësi fetare hinduse, mirëpo ishte shumë i ndikuar nga Islami dhe muslimanët e asaj kohe.

Përkufizimi i sikhut dhe i Sikhizmit

Fjala 'sikh' rrjedh nga fjala "sisja" që do të thotë dishepull ose pasues besnik. Sikhizmi

²⁹ Guru quhet personi i cili, në një zonë të caktuar, konsiderohet si shumë i ditur, i urtë dhe me autoritet. Në Hinduizëm, Budizëm dhe Sikhizëm kuptohet edhe si mësues ose udhëzues shpirtëror.

është fe e dhjetë guruve, i pari prej të cilëve ishte Guru Nanak, deri të Guru Gabin Singh, i cili konsiderohet i dhjeti dhe i fundit. Libri i shenjtë i Sikhizmit është 'Sri Guru Granth i njohur edhe si 'Abi Granth Sahib.'

Pese shkronjat 'K'

Çdo pasues i Sikhizmit duhet të mbajë pesë gjëra që fillojnë me shkronjën 'K', të cilat njëkohësisht shërbejnë edhe për identitetin e tij.

I) Kesh – flokët e gjata; veprim që e kanë praktikuar të gjithë gurutë.

II) Kangha - krehër; për t'i mbajtur flokët pastër.

III) Kada - byzylyku i metaltë apo i çeliktë; për forcë dhe vetëpërmbajtje.

IV) Kirpan – thikë e mprehur nga të dyja anët për vetëmbrojtje.

V) Koccha - veshje e brendshme që arrin deri tek gjunjët.

Mul Mantra - Besimi fundamental i Sikhizmit

Përkufizimi me i mire që një pasues i Sikhizmit mund të japë për konceptin e Zotit është 'Mul Mantra'. Ky besim është paraqitur në kohën e Guru Granth Sahib dhe cilësohet si besimi fundamental i Sikhizmit.

Është përmendur në Sri Guru Granth Sahib (vol. 1, Japuj, verseti i parë):

"Ekziston vetëm një Zot, i cili quhet Krijuesi i Vërtetë. I lirë nga frika dhe urrejtja, i pavdekshëm, i pa krijuar, vetekzistent, i Madhëruar dhe i Mëshirshëm. "

Sikhizmi i urdhëron në mënyrë të përpiktë pasuesit e tij për besim monoteist. Në këtë fe besohet në një Zot Suprem i cili në formën e pamanifestuar njihet si 'ek Omkara' kurse në formën e manifestuar quhet 'Omkara' dhe ka disa emra:

Kartar - Krijuesi

Sahib - Zotëruesi

Akal - I Përherëshmi

Sattanama - Emri i Shenjtë

Parvardigar - Sunduesi

Rahim - I Mëshirshmi

Karim - I Dashuri

Quhet edhe 'Vahe Guru' - Zoti i Vetëm i Vërtetë. Përkrah të qenët fe monoteiste, Sikhizmi nuk e pranon besimin në doktrinën e ri-mishërimit dhe është rreptësisht kundër adhurimit të idhujve.

Guru Nanak i ndikuar nga Kabiri

Guru Nanak ka qenë shumë i ndikuar nga thëniet e Sant Kabir, saqë shumë pjesë të librit re tij 'Sri Guru Nanak', i cili konsiderohet si i shenjtë nga pasuesit e Sikhizmit, përmbajnë vargje të Sant Kabirit.

Një nga vargjet mete famshme të tij është:

'Vukh mein Sumirana sabah karein Sukh

mein karein na koyaJo sukh mein sumirana karein To dukh kaye hoye. " (Te gjithë e kujtojnë Zotin kur janë në vështirësi) por askush nuk e kujton Atë gjatë rehatisë dhe mirëqenies. Ai i cili e kujton Zotin kur është i qetë dhe i lumtur, pse duhet të këtë telashe?)

Krahasoni këtë varg me ajetin vijues nga Kurani i Madhëruar:

“E kur e godet njeriun ndonjë e keqe (ndonjë dëm), ai e lut Zotin e vet duke kërkuar ndihmë vetëm prej Tij, e kur nga ana e Tij i jep ndonjë të mirë (ia largon të keqen), ai e harron atë që me parë i është lutur Atij dhe i përshkruan shokë Allahut.”³⁰

³⁰ Kuran, 39:8.

KONCEPTI I ZOTIT NË ZOTOASTRIANIZËM

Zoroastrianizmi është fe e lashte asiriane, e cila ka zënë fill në Persi para me se 2500 vitesh. Megjithëse ka pak ithtarë (më pak se 130 000 në tërë botën), konsiderohet si njëra ndër fetë më të vjetra. Themelues i kësaj feje (e njohur edhe si Parsizëm) konsiderohet (profeti iranien Zoroaster. Shkrimet e shenjta të kësaj feje janë 'Dasastir' dhe 'Avesta.'

Në këtë fe, Zoti njihet si 'Ahura Mazda,' ku 'Ahura' do të thotë Zot, kurse 'Mazda' - i Urtë. Pra, 'Ahura Mazda' do të thotë 'Zoti i Urtë'.

Cilësitë e Zotit sipas Dasastir

Sipas librit të shenjtë Zotoastrian Dasastir, 'Ahura Mazda' ka këto cilësi:

- I) Ai është Një
- II) Asgjë nuk i ngjan Atij
- III) Ai është pa fillim dhe pa mbarim

IV) Ai nuk ka baba, nënë, grua ose djalë

V) Nuk ka trup apo formë

VI) Sytë nuk mund ta shohin Atë e as fuqia e mendimi nuk mund ta përfytyrojë

VII) Ai është mbi gjithë atë që mund të imagjinosh.

VIII) Është më afër teje sesa vetja jote

Cilësitë e Zotit bazuar në Avesta

Bazuar në librin tjetër të shenjtë të kësaj feje, Avesta, në Gathas dhe Yasna, vërejmë karakteristika të ndryshme të Ahura Mazdes si:

I) Krijuesi³¹

II) I Plotfuqishmi - i Madhërishmi³²

III) Bamirësi – ‘Hudai’³³

³¹ Yasna, 31:7 & 11; Yasna 44:7; Yasna 50:11; Yasna 51:7.

³² Yasna 33:11; Yasna 48:3.

IV) Shpërblyesi – ‘Spenta’³⁴

³³ Yasna 33:11; Yasna 48:3.

³⁴ Yasna 43:4, 5, 7, 9, 11, 13, 15; Yasna 44:2; Yasna 45:5.

KONCEPTI I ZOTIT NË JUDAIZËM

Judaizmi është njëra nga fetë e mëdha semitike. Ndjekësit e saj njihen si hebrenj dhe besojnë në profetësinë e Musait.

I) Verseti vijues nga Deutoronomi përmban një deklaram nga Musai:

“Shama Israelu Adonai Ila Hayno Adna Ikhad!”

Është një citim në gjuhën hebraike, që do të thotë: ‘Dëgjo, o Izrael! Zoti ynë është një Zot.’³⁵

II) Analizoni versetin vijues nga Libri Isaiah:

“Unë, Unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër.”³⁶

III) “Unë jam Zoti dhe nuk ka asnjë tjetër, jashtë Meje nuk ka Perëndi.”³⁷

IV) Unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër;

³⁵ Deutoronomi 6:4.

³⁶ Bibla, Isaiah, 43:11.

³⁷ Bibla, Isaiah, 45:5.

jam Perëndia dhe askush nuk me ngjet Mua.³⁸

V) Judaizmi e qorton adhurimin e idhujve në versetin vijues:

“Nuk do të kesh Perëndi të tjera para Meje. Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiejt ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë. Nuk do të përkulesh para tyre dhe as do t'i shërbesh, sepse Unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xheloz.”³⁹

VI) Një mesazh i ngjashëm përsëritet edhe në librin e Deuteronomit:

"Nuk do të kesh Perëndi të tjera përpara meje. Nuk do të bësh asnjë skulpturë apo shëmbëlltyrë të gjërave që janë atje lart në qiell, këtu poshtë në tokë apo në ujërat poshtë tokës. Nuk do të biesh përmbys para tyre dhe nuk do t'u shërbesh, sepse Unë Zoti, Perëndia yt jam

³⁸ Bibla, Isaiah, 46:9.

³⁹ Bibla, Ekzodi, 20:3-5.

një Perëndi xheloz.”⁴⁰

⁴⁰ Bibla, Deuteronomi, 5:7-9.

KONCEPTI I ZOTIT NË KRISHTERIZËM

Krishterimi është fe semitike, e cila pretendon se ka rreth 2 miliardë ithtarë anembanë botës. Kjo fe e mori emrin nga Jezus Krishti, i cili nderohet dhe besohet edhe në fenë Islame. Madje, Islami është e vetmja fe jo e krishtere që urdhëron për besim në Jezusin si i Dërguar i Zotit.

Para se të diskutojmë konceptin e Zotit të feja e krishtere, le të analizojmë pozitën e Jezusit në Islam.

1. Islami është feja e vetme jo e krishtere, e cila besimin të Jezusi e vendos si shtyllë të besimit. Asnjë musliman nuk është i këtillë nëse nuk e beson edhe Jezusin.

2. Ne besojmë se ai ishte njëri nga të Dërguarit më të mëdhenj të Allahut.

3. Në besojmë se lindja e tij ishte mrekulli; pa ndonjë ndërhyrje nga ndonjë mashkull, gjë të cilën shumë të krishterë bashkëkohorë nuk e besojnë.

4. Në besojmë se ai i ringjalli të vdekurit me lejen e Zotit.

5. Në besojmë se ai i shëroi të lindurit e verbër dhe të lebrosurit.⁴¹

Dikush mund të pyesë: Nëse muslimanët dhe të krishterët e duan dhe e respektojnë Jezusin, atëherë ku saktësisht kundërshtohen mes vete? Dallimi kryesor mes Islamit dhe Krishterimit qëndron në insistimin e të krishterëve për natyrën hyjnore të Jezu Krishtit. Studimi i shkrimeve të shenjta të krishtera zbulon faktin se Jezusi kurrë nuk e ka pretenduar një gjë të tillë, madje nuk ka as edhe një thënie të vetme në tërë Biblën ku Jezusi personalisht të këtë thënë: "Unë jam Zot, apo 'Më adhuronit mua!' Për më tepër, Bibla përmban thënie të cilat i atribuohen Jezusit, në të cilat predikohet e kundërta. Analizoni thënien e mëposhtme biblike, e cila i atribuohet Jezusit:

⁴¹ Semundje kronike e lekures e shkaktuar nga mikrobakteria 'leprac'. Njihet edhe si sëmundja 'Hansen.'

“Ai është më i Madh se unë.”⁴²

“Ati im, që m'i dha, është më i madh se të gjithë.”⁴³

“... unë i dëboj djajtë me ndihmën e Frymës së Perëndisë ...”⁴⁴

“... i dëboj demonët me gishtin e Perëndisë ...”⁴⁵

“Unë s'mund të bej asgjë nga vetja ime; gjykoj sipas asaj që dëgjoj dhe gjyqi im është i drejtë, sepse nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e Atit që më ka dërguar.”⁴⁶

Misioni i Jezu Krishtit! Ai erdhi për të plotësuar shpalljen

Jezusi kurrë nuk pretendoi se është Qenie Hyjnore. Për më tepër, ai e deklaroi qartë

⁴² Gjoni, 14:28.

⁴³ Gjoni, 10:29.

⁴⁴ Maten, 12:28.

⁴⁵ Luka 11:20.

⁴⁶ Gjoni, 5:30.

natyrën e misionit të tij kur tha se ishte dërguar nga Zoti dhe kishte ardhur për të konfirmuar shpalljen paraprake judaike. Kjo vërehet qartë në thënien e mëposhtme në Ungjillin e Mareut: “Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar ligjin ose Profetët; unë nuk erdha për t’i shfuqizuar, po për t’i plotësuar. Sepse në të vërtetë ju them: Derisa qielli dhe toka, të kalojnë asnjë jotë a asnjë pikë e ligjit nuk do të kalojnë, para se të plotësohet gjithçka. Ai, pra, që do të shkellë një nga këto urdhërime më të vogla dhe do t’u ketë mësuar kështu njerëzve, do të quhet më i vogli në mbretërinë e qiejve; kurse ai që do t’i vejë në praktikë dhe do t’ua mësojë të tjerëve, do të quhet i madh në mbretërinë e qiejve.”⁴⁷

Zoti e dërgoi Jezusin

Bibla e përmend natyrën profetike të misionit të Jezusit në versetet vijuese:

⁴⁷ Bibla, Mateu 5:17:20.

“... dhe fjala që po dëgjoni nuk është imja, por e Atit që më ka dërguar.”⁴⁸

“Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin Ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.”⁴⁹

Jezusi e refuzoi edhe dyshimin me të vogël që do të shpinte në mendimin se ai ka natyrë hyjnore. Analizoni ngjarjen vijuese të përmendur në Bibël:

"Dhe ja, iu afrua dikush dhe i tha: "Mësues i mirë, çfarë të mire duhet të bëj që të kem jetë të përjetshme?" Dhe ai tha: "Pse më quan të mirë? Askush nuk është i mirë përveç një të Vetmi: Perëndia. Tani në qoftë se ti do të hysh në jete, zbato urdhërimet.”⁵⁰

Thënia e mësipërme biblike e hedh poshtë dogmën e krishterë për natyrën hyjnore të

⁴⁸ Bibla, Gjoni 14:24.

⁴⁹ Bibla, Gjoni 17:3.

⁵⁰ Bibla, Mateu, 19:16-17.

Jezusit dhe të shpëtimit përmes tij. Siç u pa edhe me sipër, Jezusi e urdhëroi pyetësin që t' u përmbahet urdhëresave, nëse dëshiron ta arrijë shpëtimin.⁵¹

Jezusi i Nazaretit⁵² - njeri i aprovuar nga Zoti

Thënia e mëposhtme nga Bibla e mbështet besimin islam se Jezusi ishte Profet i Zotit.

“Burra të Izraelit, dëgjoni këto fjali: Jezusi i Nazareas, njeriu i dëftuar nga Perëndia ndër ju me vepra të fuqishme, me mrekulli dhe shenja që Perëndia beri ndër ju me anë të tij, siç edhe vetë e dini.”⁵³

⁵¹ E nuk i rha që ta kerkoje shpëtimin përmes tij (sh.p.).

⁵² Qytet i madh në distriktin verior të Izraelit. Në Dhiaten e Re përshkruhet si vendi në të cilën e kaloi fëmijërinë Jezusi dhe si i tillë konsiderohet si qendër për pelegrinët e krishterë.

⁵³ Veprat e Apostujve, 2:22.

Urdhri i parë: Zoti është Një

Bibla nuk e përkrah fare besimin e krishterë për trinitetin. Tregohet se njëherë, njëri prej shkruesve e pyeti Jezusin se cili ishte urdhri i parë. Kësaj pyetjeje Jezusi iu përgjigj⁵⁴ thjesht duke përsëritur atë që kishte thënë me herët Musai:

"Shama Israelu Adonai Rayno Adna lkhat. "

⁵⁴ Allahu në Kuran thotë: "Dhe kur Allahu tha: 'O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: 'Me besoni mua dhe nënës time dy zota pos Allahut!?' (Isai) Tha: 'Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë: ti do ta dije. Ti e di çka në mua, e unë nuk di çfarë ka në Ty. Ti je mi i dijsلمي i të fshehtave! Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, pos asaj që Ti më urdhërove: ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta kam qenë përcjellës i tyre, e pasi më more mua, Ti ishe roje (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send! Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robër Tu, e nëse ua falë atyre, Ti je i Gjithëfuqishmi, i Urti." (Kuran, 5:116-118)

Dhe Jezusi u përgjigj: “Urdhërimi i parë i të gjithëve është: 'Dëgjo, o Izrael! Zoti, Perëndia ynë, ishte i vetmi Zot.’⁵⁵

⁵⁵ Marku, 12:29

KONCEPTI I ZOTIT NË ISLAM

Islami është fe semitike, e cila ka mbi 1.2 miliardë besimtarë në të gjithë botën. Islam do të thotë nënshtrim ndaj dëshirës së Allahut. Muslimanët e pranojnë Kuranin si fjalë të Zotit, të zbritur Profetit Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Islami deklaron se Allahu ka dërguar Profetë përgjatë kohërave, që të predikonin njëshmërinë e Zotit. Kështu, Islami e bën kusht besimin te Profetët e mëhershëm⁵⁶;

⁵⁶ Allahu në Kuran thotë: "Në dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: 'Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)' (Kuran, 16:36) Po ashtu thotë: "O ju që besuat! Besoni vazhdimisht Allahun, të Dërguarin c Tij, Librin që gradualisht ia shpalli të Dërguarit të Tij dhe librin që e pat zbritur më parë. Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botes tjetër, ai ka humbur tepër larg. " (Kur- an, 4:126) Dhe: 'ju (besimtare) thoni: 'Në i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit), atë që i është dhënë

duke filluar nga Ademi (Adami), pastaj Nuhu (Noa), Ibrahim (Abrahami), Ismaili (Ishmaeli), Is'haku (Isaku), Jakubi (Uakobi), Musai (Moisiu), Davudi (Davidi), Junusi (Jona), Isai Oezusi dhe shumë të tjerë.

Përkufizimi me konciz për Zotin

Përkufizimi me konciz për Zotin në Islam është dhënë në katër ajetet e sures 'Ihlas': që është kapitulli 112 në Kuranin e Shenjtë:

"1. Thuaj: Ai, Allahu është Një!

2. Allahu është 'Es-Samed' - Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë.

3. Ai s'ka lindur kë, as nuk është i lindur.

4. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë."

Emri 'Es-Samed' është i vështirë për t'u

Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre profetëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm Atij i jemi bindur." (Kuran, 2:136)

përkthyer. Ai do të thotë 'Zot absolut dhe sovran në sundimin e Tij' Kjo shprehje mund t'i atribuohet vetëm Allahut sepse të gjitha krijesat e tjera janë të përkohshme ose të kushtëzuara. Po ashtu, ky emër nënkupton se Allahu është i pavarur nga çdo gjë, ndërsa të gjitha gjërat varen vetëm prej Tij.

'Surja Ihlas' - kriter i teologjisë

(Theo' në gjuhën greke do të thotë Zot, ndërsa 'logos' studim, shkencë. Kështu, teologjia nënkupton sundimin e Zotit. Për muslimanët, ky përkufizim prej katër rreshtash, i dhënë në suren Ihlas, shërben si bazë dhe kriter në studimin e Zotit. Prandaj, çdo pretendues i natyrës hyjnore duhet t'i nënshtrohet këtij 'testi'. E, përderisa Cilësitë e Allahut të përmendura në këtë sure janë unike, zotat dhe pretenduesit e rremë do të demaskohen dhe eliminohen shumë lehtë duke përdorur këto ajete.

Ç 'thotë Islami për 'njeriun-zot'?

India shpeshherë quhet vendi i 'njerëzve-zot: Kjo vjen si pasojë e numrit të madh të të ashtuquajturve 'mësues shpirtërorë' të cilët jetojnë dhe veprojnë në këtë vend.

(Shumë prej tyre pasohen në shumë shtete të botës nga një numër i madh njerëzish. Mirëpo Islami e refuzon një hyjnizim të tillë të qenieve njerëzore.

Për ta kuptuar më mirë qëndrimin e Islamit ndaj personave të tillë, le të analizojmë njërin prej 'njerëzve-zot,' të quajtur Osho Rajnish. Rajnishi ishte njëri prej shumë mësuesve shpirtërorë të dalë nga gjiri i Indisë. Në maj të viti 1981, ai shkoi në SHBA, ku formoi një qytezë të quajtur 'Rajnishpuram'. Më vonë, ai u shpall person i padëshiruar nga SHBA-ja, u arrestua dhe iu kërkua të largohej. Me t'u kthyer në Indi, ai themeloi një komunitet në qytetin Pune, i cili sot njihet si komuniteti 'Osho.' Vdiq më 1990. Pasuesit e Osho Rajnish besojnë se ai është vetë Zoti i Plotfuqishëm.

Vizituesi i komunës 'Osho' do të gjëje epitafin vijues në gurin e varrit të tij:

“Osho kurrë nuk ka lindur, kurrë nuk ka vdekur; vetëm se e vizitoi planetin Tokë në mes 11 dhjetorit 1931 dhe 19 janarit 1930.”

Por ata kanë harruar të përmendin se atij nuk i është dhënë viza për të hyrë në 21 shtete të ndryshme. Megjithatë, pasuesit e Rajnishit nuk shohin ndonjë problem te 'zoti' i tyre, i cili e viziton Tokën dhe kërkon vizë për të hyrë në një shtet.

Le ta fusim në testin e sures Ihlas kandidatin për hyjni

- Bhagëan Rajnish:

I) Kriteri i parë është “*Thua: Ai, Allahu është Një!*” A është Rajnish një dhe i vetëm? Jo! Ka shumë njerëz të ngjashëm me Rajnishin, të cilët pretendojnë se kanë natyrë hyjnore. Megjithatë disa dishepuj të Rajnishit ndoshta edhe me tej mbajnë mendimin se ai është një dhe i vetëm.

II) Kriteri i dytë është: “Allahu është Absolut

dhe i Përhershëm.” Rajnishi, sigurisht se nuk ishte absolut e as i përhershëm, përderisa dihet se ka vdekur me 1990. Për më tepër, nga biografia e tij dimë se ka vuajtur nga diabeti, astma dhe dhimbjet kronike të shpinës. Madje ai supozonte se qeveria amerikanë e kishte helmuar, duke i dhënë helm me efekt të ngadalshëm gjatë qëndrimit të tij në burg. Imagjinoni Zotin e Plotfuqishëm që helmohet!? Pra, Rajnishi nuk ishte as absolut e as i përhershëm.

III) Kriteri i tretë: “As s'ka lindur kë, e as nuk është i lindur.” Ne e dimë se Rajnishi ka lindur në Jabalpur të Indisë dhe ka pasur prindër, të cilët me vonë janë bërë pasues të tij.

IV) Kriteri i katërt, i cili njëkohësisht është edhe kriteri me rigoroz: “Dhe Atij askush nuk i ishte i barabartë.” Në momentin që 'zoti' mund të imagjinohet apo të krahasohet me diçka, ai (pretenduesi për natyrë hyjnore) del se nuk është zot. Është e pamundur të imagjinohet një pikturë mentale, e cila do të ishte reale për

Zotin e Vetëm dhe të Vërtetë. Në e dimë se Rajnishi ishte qenie njerëzore me mjekër të gjatë e të bardhë. Kishte dy sy, dy veshë, një hundë dhe një gojë. Madje, fotografitë dhe posterat e tij mund të gjenden me bollëk edhe sot.

Cili është konkludimi i gjithë këtij të ashtuquajturë test? Ky test nuk mund të kalohet nga askush, përveç Zotit të Vërtetë.

Si e quajmë Zotin?

Muslimanët preferojnë që Zotin ta quajnë Allah, në vend të fjalës 'Zot'. Emri arab 'Allah' është i pastër dhe unik, ndryshe nga emri 'Zot', me të cilin mund të manipulohet.

Kështu, emri Zot mund të shndërrohet në shumë, në gjini femërore, etj., kurse emri 'Allah' nuk ka gjini e as nuk mund të këtë dyjësi apo shumë. Allah është emër unik, i cili nuk shpie të ndonjë pikturë mentale dhe me të nuk mund të manipulohet. Për këtë arsye, muslimanët e preferojnë këtë emër. Mirëpo,

ndonjëherë, kur flasim me jomuslimanët, na duhet ta përdorim emrin 'Zot'. Duke qenë se ky libër i dedikohet një audiencë më të gjerë, përfshirë këtu muslimanë dhe jomuslimanë, kemi përdorur emrin 'Zot', në vend të Allah.

Zoti nuk personifikohet në qenie njerëzore

Disa njerëz, duke u nisur nga fakti se Zoti mund të bëjë gjithçka, thonë se pse atëherë Ai nuk mund të marrë formën e njeriut? Themi se, nëse Zoti do, mund të bëhet njeri! Mirëpo, atëherë nuk mbetet Zot, sepse cilësitë e Zotit dhe të qenieve njerëzore nuk përputhen në shumë aspekte. Paragrafi vijues do të sjellë në pah absurditetin e idesë se shndërrimit të Zotit në qenie njerëzore.

Zoti është i pavdekshëm kurse njerëzit vdesin, prandaj nuk mund të kesh një 'Zot-njeri', një qenie të pavdekshme dhe të vdekshme njëkohësisht. Është e pakuptimtë! Pastaj, Zoti është i pafillm, kurse njerëzit e kanë një fillim. Nuk mund ta kesh një person të

pa fillim të dhe në të njëjtën kohe të këtë një fillim. Njerëzit kanë një fund, kurse Zoti jo! Nuk mund të kesh një qenie e cila nuk ka fund dhe ka fund në të njëjtën kohe. Është e pakuptimtë.

Për me tepër, Zoti i Plotfuqishëm nuk ka nevojë për ushqim, ndërkohë që njerëzit kanë nevojë për të mbijetuar:

“Thuaj: ‘A pos Allahut, krijues i qiejve dhe i tokës, që ushqen të tjerët, ndërsa vetë nuk ushqehet, të pranoj Zot tjetër?’”⁵⁷

Zoti nuk ka nevojë për pushim ose gjumë, përderisa njerëzit nuk mund të qëndrojnë për kohë të gjatë pa pushuar:

“Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumi, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij.”⁵⁸

⁵⁷ Kuran, 6:14.

⁵⁸ Kuran, 2:255.

Adhurimi kushtuar njerëzve është i padobishëm.

Nëse ideja e shndërrimit të Zotit në njeri është e papranueshme, atëherë duhet të pajtohemi edhe me faktin se është e pakuptimtë të adhurohet një qenie njerëzore. Kështu, nëse Zoti merr formën e njeriut, Ai del prej të qenët Zot dhe merr të gjitha Cilësitë e njeriut. P.sh., nëse një profesor shumë i aftë pëson një aksident dhe vuan nga humbja e pakthyeshme e kujtesës, do të ishte marrëzi nga ana e studentëve të tij po të vazhdonin të merrnin mësim prej tij.

Për me tepër, nëse Zoti merr formën e njeriut, ky njeri nuk mundet me vonë që të bëhet përsëri Zot, pasi qeniet njerëzore nuk e kanë fuqinë të behën Zot. Pra, adhurimi i Zotit në formë njeriu është alogjik dhe duhet të urrëhet në të gjitha format e saj.

Për këtë arsye, Kurani i Shenjtë shprehet kundër të gjitha formave të antropomorfizimit. Në një ajet thuhet:

"Asnjë send nuk është si Ai."⁵⁹

Zoti nuk kryen vepra johyjnore

Atributet e Zotit të Plotfuqishëm përjashtojnë çdo të keqe, përderisa Ai është burim i drejtësisë, i mëshirës dhe i së vërtetës. Nuk mund të imagjinojmë Zotin duke gënjer, duke bërë padrejtësi, duke gabuar, duke harruar dhe dobësi të tjera të natyrës njerëzore. Zoti, nëse do, mund të bëjë padrejtësi, por Ai kurrë nuk e bën një gjë të tillë, sepse padrejtësia është vepër johyjnore.

Në Kuran thuhet:

"S'ka dyshim se Allahu nuk bën të padrejtë as sa grimca."⁶⁰

⁵⁹ Kuran, 42:11.

⁶⁰ Kuran, 4:40.

Zoti nuk harron e as nuk gabon

Zoti nuk harron asgjë, ngase harresa është vepër johyjnore, e cila u përket kufizimeve njerëzore. Ngjashëm, Zoti nuk gabon sepse gabimi është po ashtu johyjnor.

"... Zoti im nuk gabon e as nuk harron."⁶¹

Zoti kryen vepra hyjnore

Ai ka fuqi për çdo gjë. Koncepti i Zotit në Islam është se Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Në Kuran thuhet në shumë vende:

"Allahu ka mundësi për çdo send."⁶²

Me tej thuhet:

"Allahu bën atë që dëshiron."⁶³

Në fund, themi se duhet të mbahet mend

⁶¹ Kuran, 20:52.

⁶² Kuran, 2:106; Kuran, 2:109; Kuran, 2:284; Kuran, 3:29; Kuran, 16:77; Kuran, 35:1.

⁶³ Kuran, 85:16.

se Allahu kryen vetëm vepra hyjnore dhe jo vepra johyjnore. Shumë besime në mënyrë direkte ose indirekte besojnë në filozofinë e antropomorfizimit, respektivisht, shndërrimit të Zotit në qenie njerëzore. Ata mbështeten në faktin se Zoti është aq i pastër dhe i shenjtë, saqë nuk i njeh vështirësitë, dobësitë dhe ndjenjat e qenieve njerëzore. Prandaj në emër të vendosjes së rregullave për njerëzit, Ai zbriti në tokë duke marre formë njerëzore. Një logjikë e tillë ka mashtruar me miliona njerëz përgjatë shekujve. Prandaj, del si detyrë që ta analizojmë qëndrueshmërinë e argumentimit që përmendin ata.

Krijuesi përgatiti (udhëzuesin) e përdorimit

Allahu na ka pajisur me arsye dhe inteligjencë. Në zbulojmë dhe prodhojmë aparatura të ndryshme për qëllime të caktuara. Mirëpo, gjatë këtij procesi, asnjëherë nuk është sugjeruar që në emër të kuptimit se çfarë është më mirë për produktin që prodhojmë, në të

bëhemi vetë produkt. Meqë prodhuesi e njeh me mirë se të gjithë produktin e tij, ai thjesht i shoqëron atij edhe udhëzuesin e përdorimit, në të cilin jepen shkurtimisht ato që duhen apo nuk duhen për produktin.

Nëse e mendoni njeriun si një makinë, ai në të vërtetë është një krijesë komplekse e Allahut. Zoti, Krijuesi ynë, nuk ka nevojë të vijë në formën e njeriut për ta mësuar se ç'është e mirë apo e keqe për ne. Ai vetëm i jep njeriut udhëzuesin për përdorim, i cili është Kurani i Madhëruar.

Allahu zgjedh të Dërguarit

Allahu nuk ka nevojë të zbresë personalisht për t'i shkruar udhëzimet. Mirëpo, përgjatë kohërave, Ai ka zgjedhur njerëz nga çdo popull për të kumtuar mesazhin hyjnor. Këta të zgjedhur quhen Profetë të Zotit.

Disa njerëz janë 'të verbër' dhe 'të shurdhër'

Disa njerëz janë me të vërtetë të 'shurdhër'

dhe 'të verbër', edhe pse Allahu ua ka dhënë shqisën e të dëgjuarit dhe të parit.

“Të shurdhër, memecë dhe të verbër, andaj ata nuk kthehen (nga ajo rrugë e tyre e keqe).”⁶⁴

Bibla jep një mesazh të ngjashëm, në Ungjillin e Mateut:

“Duke parë nuk shohin, dhe duke dëgjuar nuk dëgjojnë e as nuk kuptojnë.”⁶⁵

Po ashtu edhe në Veden Rig, në librin e shenjtë hindus:

"Ndoshta dikush i lexon fjalët, por në të vërtetë nuk i ka parë ende; ndoshta një tjetër i dëgjon ato, por nuk i ka dëgjuar në të vërtetë.”⁶⁶

Këto shkrime të shenjta i informojnë lexuesit se gjërat janë të qarta, por edhe me tej ata largohen nga e vërteta.

⁶⁴ Ku ran, 2:18.

⁶⁵ Mateu) 13:13.

⁶⁶ Rigveda, 10:71:4.

EMRAT DHE CILËSITË E ZOTIT

Allahut i përkasin emrat me të bukur.

Në Kuranin e Shenjtë thuhet:

“Thuaj: "Thërrisni: ‘Allah’ ose thërrisni ‘Er-Rahman,’ me cilindo që ta thërrisni (prej këtyre dy emrave), emrat e Tij janë më të bukurit.”⁶⁷

Një mesazh i ngjashëm për emrat e bukur të Allahut është përmendur edhe në vende të tjera në Kuran:

"Allahu ka emrat më të mirë, andaj Atë thirrreni me ta.”⁶⁸

“Ai është Allahu, nuk ka zot pos Tij, Atij i takojnë emrat më të bukur.”⁶⁹

“Ai është Allahu që nuk ka zot tjetër pos Tij, që e di të fshehtën dhe të dukshmen, Ai është Mëshiruesi, Mëshirëbërësi! Ai është Allahu që

⁶⁷ Kuran, 17:110.

⁶⁸ Kuran, 7:180.

⁶⁹ Kuran, 20:8.

nuk ka zot tjetër përveç Tij; sundues i përgjithshëm, i pastër (prej të metave që i vishen), shpëtimtar (që i shpëton njerëzit prej ndëshkimit të padrejtë), sigurues (që i siguroi njerëzit me premtimin e vet dhe Pejgamberët me mrekulli) mbikëqyrës (që mbikëqyr dhe përcjell çdo send), i plotfuqishëm, mbizotërues, i madhërishëm. I Lartësuar është Allahu nga çka i shoqërojnë!”⁷⁰

Kurani përmend plot 99 emra të ndryshëm të Zotit të Plotfuqishëm dhe emri me i madh është emri Allah.

Kurani i referohet Allahut me Er-Rahman (Mëshiruesi), Er-Rrahim (Mëshirëbërësi) dhe El-Hakim (I Urti), në mesin e shumë emrave të tjerë. Allahu mund të quhet me çdo emër i cili i plotëson kushtet e caktuara, disa prej të cilave do të përmenden në vijim.

Çdo emër i Zotit është unik dhe i takon vetëm Atij.

⁷⁰ Kuran, 59: 23-34.

Jo vetëm që çdo emër i Allahut është unik, por po ashtu çdo emër i Tij duhet të jetë i mjaftueshëm për ta identifikuar Atë. Dëshiroj që këtë pikë ta sqaroj në detaje, kështu që le të marrim shembullin e një personaliteti të famshëm, të themi Neil Armstrong.

Nëse dikush thotë se "Neil Armstrong" është amerikan, kjo është e saktë; Mirëpo nuk mjafton që ta identifikojë atë. Apo nëse themi 'Neil Armstrong është astronaut,' të qenët astronaut nuk është unike për të.

Mirëpo, nëse themi se 'Neil Armstrong ishte njeriu i parë që shkeli në Hënë, atëherë kjo do të ishte unike për të. Pra, nëse dikush pyet se kush shkeli i pari në Hënë, e vetmja përgjigje është: Neil Armstrong. Ngjashëm, emrat dhe Cilësitë e Allahut duhet të jenë unik, p.sh., Krijuesi i gjithësisë. Nëse them Krijuesi i ndërtesës, mund të jetë e mundshme dhe e vërtetë, por nuk është unike, pasi me mijëra njerëz mund të ndërtojnë ndërtesa dhe nuk do të kishte dallim në mes njeriut dhe Zotit. Pra,

çdo emër i Allahut tregon vetëm për të dhe për askënd tjetër.

P.sh. "Er-Rahman" - Mëshiruesi; "Er-Rahim" - Mëshirëbërësi; "El-Hakim" - I Urti.

Kur pyet dikush se kush është "Er-Rahim" ekziston vetëm një përgjigje: Allahu!

Një emër i Zotit nuk duhet të kundërshtohet nga emrat e tjerë

Për ta vazhduar shembullin e mëparshëm, nëse dikush thotë se "Neil Armstrong është astronaut amerikan, por vetëm 120 cm i gjatë", të qenët astronaut amerikan është e saktë, por jo edhe gjatësia. Ngjashëm, nëse dikush thotë se Allahu është Krijuesi i gjithësisë dhe i përngjet njeriut, Krijuesi i gjithësisë është e sakte, por cilësia e shoqëruar është e gabuar.

Të gjithë emrat dhe Cilësitë e Allahut duhet të tregojnë një Zot

Përderisa ekziston vetëm një Zot, të gjithë emrat dhe atributet duhet të tregojnë për të njëjtin Zot. Nëse themi se Krijuesi është një

Zot, kurse Furnizuesi një Zot tjetër është absurde, sepse ekziston vetëm një Zot që i posedon të gjithë këta emra dhe cilësi.

NJËSHMËRIA E ZOTIT

Disa politeiste thonë se ekzistenca e me shumë se një Zoti nuk është krejtësisht jologjike. Pra, le ta shqyrtojmë këtë.

Nëse do të ekzistonte më shumë se një Zot, ata do të polemizonin me njëri-tjetrin dhe secili do të mundohej që dëshirën e tij ta vendoste mbi dëshirat e zotave të tjerë. Kjo mund të vërehet në mitologjinë e feve politeiste dhe panteiste. Për me tepër, nëse një 'zot' është i mposhtur apo i pafuqishëm që t'i mposhtë të tjerët, ai sigurisht që nuk është zot i vetëm.

Gjithashtu, në mesin e feve politeiste është shumë e popullarizuar ideja e shumë zotave me përgjegjësi të ndryshme, secili me një përgjegjësi të rëndësishme për ekzistencën e njeriut (Zoti i Diellit, i shiut etj.). Nëse kjo do të ishte e vërtetë, atëherë kolaudojmë se Zoti është i pafuqishëm ose jo kompetent për veprime të caktuara dhe për me tepër injorant për detyrat dhe përgjegjësitë e zotave të tjerë. Mirëpo, është e pamundur që Zoti të jete injorant ose i

pafuqishëm.

Pastaj, nëse do re kishte me shumë se një Zot, pa dyshim se një gjendje e tillë do të shpinte në konfuzion, çrregullim, kaos dhe shkatërrim në univers. Por, siç edhe e vërejmë, universi është në harmoni të plotë.

Në Kuran thuhet:

"Sikur të kishte në to (në qiej e në tokë) zota pos Allahut, ato të dyja do të shkatërroheshin. Larg asaj që i përshkruajnë është Allahu, Zoti i Arshit."⁷¹

Nëse do të kishte me shumë se një Zot, secili do të merrte atë që ka krijuar. Në Kuran thuhet:

"Allahu nuk ka marrë për Vete kurrfarë fëmije (as nga engjëjt, e as nga njerëzit), nuk ka me Të ndonjë zot tjetër, pse (sikur të kishte zot tjetër), atëherë secili zot do të veçohet me atë që ka krijuar dhe do të dominonin njëri mbi tjetrin! I lartë, i pastër është Allahu nga ato që ia

⁷¹ Kuran, 21:22.

përshekruajnë.⁷²

Kështu, ekzistimi i një Zoti të Vërtetë, të Plotfuqishëm e Suprem, është koncepti i vetëm logjik për Zotin.

Ekzistojnë disa fe, si Budizmi dhe Konfucianizmi, të cilat janë fe agnostike⁷³. Këto fe nuk flasin për Zotin, as nuk e pranojnë e as nuk e mohojnë ekzistencën e Tij. Madje ka edhe fe të tjera, si Jainizmi, të cilat janë fe ateiste dhe nuk besojnë fare në ekzistimin e Zotit.

⁷² Kuran, 23:91.

⁷³ Agnosticizmi është pikëpamje filozofike, sipas se cilës është e pamundur të vërtetohen ose të hidhen poshtë gjëra si: e vërteta, metafizika, teologjia, jeta pas vdekjes, madje edhe realiteti. Kështu që agnosticizmi rëndom quhet edhe 'tokë e askujt', në mes ateizmit dhe teizmit.

Te gjitha fetë në fund të fundit besojnë në monoteizëm.

Te gjitha fetë e mëdha që besojnë në ekzistimin e Zotit, në fund të fundit, besojnë në Një Zot Suprem. Për me tepër, të gjitha shkrimet e shenjta në fakt flasin për monoteizëm - besim në një Zot.

Njerëzit i kanë ndryshuar shkrimet e shenjta për përfitime personale

Me kalimin e kohës, shumica e shkrimeve të shenjta janë shtrembëruar dhe ndryshuar nga njerëz të ndryshëm për përfitime personale. Në këtë mënyre, besimi i shumë feve ka devijuar nga monoteizmi në panteizëm apo politeizëm.

Në Kuran thuhet:

“Është shkatërrim për ata që me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: “Ky është prej Allahut.” E për t’i arritur me të një fitim të pakët, pra është shkatërrim i madh për ta çka shkruan duart e tyre dhe është shkatërrim i

madh për ta ajo çka fitojnë.”⁷⁴

⁷⁴ Ku ran , 2:79.

TEUHIDI

Përkufizimi dhe kategoritë

Islami beson në teuhid; i cili nuk është thjesht monoteizëm, por me shumë. Teuhidi në kuptimin gjuhësor do të thotë deklaram i njëshmërisë dhe buron nga folja arabe 'vah-hade' që do të thotë njëshmëri.

Teuhidi mund të ndahet në tri kategori:

I) Teuhidi rububije

II) Teuhidi 'esma ue sifaf'

III) Teuhidi uluhije

I. Teuhidi rububije (njësimi i Allahut si Zot, Krijues e Sundues i të gjitha krijesave)

Kategoria e parë është teuhidi rububije. 'Rububije' rrjedh nga rrënja e 'Rab', që do të thotë Zot, Krijues, Sundues.

Teuhidi rububije nënkupton njësimin e Allahut si Zot, Krijues e Sundues i të gjitha

krijesave. Kjo kategori është e bazuar në konceptin se Allahu i Vetëm i ka krijuar të gjitha gjërat, kur nuk kishte asgjë. Ai i ka krijuar të gjitha gjërat ekzistuese nga asgjëja. Ai është i vetmi Krijues, Sundues, Furnizues i të gjithë universit dhe i asaj që është në të, pa pasur nevojë për ndihmën e askujt në këtë.

II. Teuhidi ‘esma ue sifaf’ (njësimi i Allahut në të gjithë emrat dhe Cilësitë e Tij)

Kategoria e dytë është teuhidi ‘esma ue sifaf,’ që nënkupton njësimin e Allahut në të gjithë emrat dhe cilësitë e Tij. Kjo kategori mund të ndahet në pesë aspekte.

1) Allahut duhet t’i referohemi ashtu siç e ka përshkruar Ai Vetën e Vet, apo siç e ka përshkruar Profeti i Tij. Atij duhet t’i referohemi ashtu siç Ai dhe Profeti i Tij e kanë përshkruar Atë, pa interpretime të emrave dhe të cilësive të Tij, duke u dhënë kështu një kuptim tjetër, jashtë kuptimit të vërtetë.

2) Allahut duhet t'i referoheni ashtu siç Ai i është referuar Vetes. Allahut duhet t'i referohemi ashtu siç Ai i është referuar Vetes së Vet, pa i shtuar emra dhe attribute të tjera. P.sh., Ai nuk mund të quhet El-Gadib (I Hidhëruari), me gjithë faktin se Ai ka thënë se hidhërohet (ndaj dikujt). Çdo emër aludon për cilësi, por jo çdo cilësi aludon për emër. Për më tepër, as Allahu e as i Dërguari i Tij, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, nuk e kanë përdorur këtë emër.

3) Allahut duhet t'i referohemi pa ia veshur atributet e krijesave të Tij. Kur flasim për Allahun, duhet të shmangemi në mënyrë të përpiktë nga veshja Atij atributet e krijesave të Tij. P.sh., në Bibël, Zoti portretizohet si i penduar për mendimet e Tij të gabuara, njësoj siç bëjnë edhe njerëzit kur kuptojnë gabimet e tyre. Kjo është plotësisht kundër principit të teuhidit. Zoti nuk bën gabime dhe nuk pendohet.

Parimi kyç për atributet e Allahut është dhënë në Kuranin e Shenjtë në ajetin e mëposhtëm:

"Asnjë send nuk është si Ai; Ai është dëgjuesi, shikuesi."⁷⁵

Edhe pse dëgjimi dhe shikimi janë cilësi njerëzore, kur ato i atribuohen Qenies Hyjnore, janë të pakrahasueshme në përsosmëri, për dallim nga rastet kur u atribuohen njerëzve, dëgjimi dhe shikimi i të cilëve është i cunguar.

4) Njerëzve nuk duhet t'u jepen atributet e Zotit. Nëse i referohemi një njeriu me atributet e Zotit, kjo është po ashtu kundër principit të teuhidit. Ketu futet, për shembull, aludimi se dikush është i pafillim dhe i pambarim (i përhershëm).

5) Emrat e Allahut nuk duhet (mund) t'u jepen krijesave të Tij. Disa emra të Allahut në formë të papërcaktuar, si 'Rauf' apo 'Rrahim', janë emra të lejuar për njerëzit, pasi Allahu i ka

⁷⁵ Kuran, 42:11.

përdorur për Profetët e Tij, mirëpo vetëm nëse përdoren me parashtesën 'abd,' që do të thotë 'rob'. Si p.sh. 'Abdur-Rauf' ose 'Abdur-Rrahim'.

III Teuhidi uluhije (njësimi i Allahut në adhurim)

1) Përkufizimi dhe kuptimi i ibadetit

Ibadet rrjedh nga fjala arabe 'abede', që do të thotë robërim ose nënshtrim. Ibadeti, pra, ka kuptimin e nënshtrimit dhe të adhurimit. Namazi është njëra nga format më të larta të adhurimit (por jo e vetmja). Njerëzit e keqkuptojnë adhurimin e Allahut, duke menduar se me këtë term nënkuptohen vetëm lutjet ditore, por koncepti i adhurimit në Islam përfshin nënshtrim dhe bindje totale. Kryerja e urdhrave të Zotit dhe shmangia nga gjërat e ndaluara është ibadet. E, ky ibadet është vetëm për Allahun dhe për askënd tjetër.

2) Të tri kategoritë e teuhidit duhet të ndiqen njëkohësisht. Besimi vetëm në dy kategoritë e

para të teuhidit, pa implementimin e teuhidit uluhije, është i padobishëm. Kurani përmend shembullin e idhujtarëve në kohën e Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, të cilët pranuan vetëm dy aspektet e para të teuhidit. Thuhet në Kuranin e Shenjtë:

“Thuaj: “Kush ju furnizon me ushqim nga qielli e toka? Kush e ka në dorë të dëgjuarit e të parët (tuaj)? Kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri e kush e nxjerr të vdekurin nga i gjalli? Kush rregullon çdo çeshtje?” Ata do të thonë: “Allahu.” Ti thuaju: “A nuk i frikësoheni (dënimit)?!”⁷⁶

E njëjta gjë përsëritet në suren Zuhruf:

“Po nëse ti i pyet kush i krijoi ata, me siguri do të thonë: “Allahu!” E si pra, i kthejnë shpinën?”

Paganet e Mekës e dinin që Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Zoti etj..., por nuk ishin muslimanë, ngase në të njëjtën kohe adhuronin

⁷⁶ Kuran., 10:31.

të tjerë (zota) përveç Allahut. Allahu i etiketoi si 'kufarë' (jomuslimanë) dhe 'mushrikë,' (idhujtarë).

“Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun, vetëm se duke i shoqëruar (zota të tjerë).”⁷⁷

Pra, tehudi uluhije është aspekti më i rëndësishëm i teuhidit. Vetëm Allahu e meriton adhurimin dhe vetëm Ai mund ta shpërblejë njeriun për këtë adhurim.

⁷⁷ Kuran, 12:106

SHIRKU

a. Përkufizimi

Refuzimi i njërës prej kategorive të lartpërmendura të teuhidit apo mangësia në plotësimin e njërës prej kritereve të teuhidit njihet si 'shirk'.

Shirku në kuptimin gjuhësor do të thotë të shoqëruarit ortak dikujt në ndonjë çështje ose pozite, kurse në kuptimin terminologjik do të thotë të shoqëruarit partner Allahut në adhurim, që është e barabartë me idhujtarinë.

b. Shirku është mëkati më i madh, të cilin Allahu nuk e fal

Kurani i Shenjtë e përshkruan mëkatin me të madh në suren Nisa:

“S’ka dyshim se Allahu nuk fal (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) ia falë kujt të dojë. Kush i

përshkruan Allahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh.”⁷⁸

“Është e vërtetë se Allahu nuk fal (mëkatin) t'i bëhet Atij shok e pos këtij (mëkati), të tjerat ia falë atij që dëshiron. Ai që i përshkruan shok Allahut, ai ka humbur dhe ka bërë një shmangie të madhe (prej se vërtetës).”⁷⁹

c. Shirku shpie në zjarr të xhehenemit

Në Kuran thuhet:

“Bënë kufër (mohuan të vërtetën} ata që thanë: "Allah është ai, Mesihu, biri i Merjemes; E vetë Mesihu, (Isai), tha: “O beni israilë: Adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka

⁷⁸ Kuran, 4:48.

⁷⁹ Kuran, 4:116.

ndihmës.”⁸⁰

d. Adhurimi duhet të jete vetëm për Allahun

Në Kuran thuhet:

"Thuaju (o i Dërguar): "O ithtarë të Librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut; të mos i bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin zota pos Allahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)."⁸¹

⁸⁰ Kuran, 5:72.

⁸¹ Kuran, 3:64.

PËRFUNDIM

Në Kuran thuhet:

“Ju mos ua shani ata (zotat) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne ia kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre e Ai i shpërblen për atë që vepruan.”⁸²

“Sikur të gjithë drunjtë në tokë të ishin lapsa, dhe sikur detit t'i shtohen edhe shtatë dete (e të jenë me ngjyrë), nuk do të mbaronin Fjalët e Allahut (do të shteronin detet, do të soseshin lapsat, por jo edhe mrekullitë e Zotit). Allahu është ngadhënyesi i Urtë.”⁸³

“O ju njerëz! Ja një shembull, veni veshin pra: Vërtetë ata që po i adhuronin në vend të Allahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të. E poqëse miza do t'ua

⁸² Kuran, 6:108.

⁸³ Kuran, 31:27.

rrëmbente atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtonin atë gjë prej saj. I dobët është edhe lutësi dhe i luturi.”⁸⁴

Te gjitha falënderimet i takojnë Allahut, Krijuesit, Sunduesit dhe Furnizuesit të të gjitha boteve!

⁸⁴ Kuran, 22: 73.